

**EMIL LAFE**

## **SHQIPJA LETRARE SI KOINE MBIDIALEKTORE**

### **Abstrakt**

Në artikull diskutohet teza e prof. A. Kostallarit se shqipja standarde përfaqëson një koine letrare sui generis dhe jo një varietet letrar që në rrethana të caktuara mori funksionet e gjuhës standarde. Autori pajtohet me këtë pikëpamje dhe përpiket ta argumentojë më tej duke marrë në shqyrtim rrethanat jashtëgjuhësore (historike, fetare, arsimore-kulturore) dhe rrethanat gjuhësore që kanë përcaktuar ecurinë e zhvillimit të shqipes letrare. Lidhur me mbështetjen e shqipes standarde mbi variantin letrar të toskërishtes autori vlerëson dy arsye kryesore: nga njëra anë, një afri më e madhe e brendshme e të folmeve të saj (sidomos të toskërishtes së mirëfilltë), dhe nga ana tjetër, një epërsi e theksuar e trevave jugore nga pikëpamja e gjendjes kulturore-arsimore, që pati si pasojë edhe epërsinë e atyre trevave në jetën politike e intelektuale. Shqipja e sotme standarde përfaqëson një zhvillim organik të koinesë letrare toske, e cila përthithi elemente të rëndësishme heterodialektore, veçanërisht në vitet '50–'60, duke u shndërruar nga një koine brenda dialektit të jugut, në një koine me elemente edhe prej dialektit të veriut.

**Fjalë kyçe:** *shqipe e shkruar, shqipe standarde, koine letrare, koine e gegërishtes, koine e toskërishtes, Kongresi i Drejtshkrimit*

Gjuha standarde shqipe është cilësuar si një *koine letrare sui generis* nga A. Kostallari<sup>1</sup>, pa hyrë në interpretimin e kuptimeve të këtij termi. Është e njohur thënia e Voltaire-it “para se të diskutojmë, të merremi vesh për termat”. Termi *koine* sot, përveç kuptimit fillestar κοινή διάλεκτος për greqishten e kohës aleksandrine, përdoret edhe me kuptimet ‘gjuhë e njësuar’, ‘varietet standard’, ‘gjuhë letrare’. Jo rrallë koineja kuptohet si njëfarë *pidgini*, d.m.th. si një tip gjuhe ku struktura e formës fillestare pëson modifikime të ndjeshme. Kështu lindin mospajtime në përdorimin e këtij termi. Unë i mbahem pikëpamjes që koineja, si rregull, ndërtohet e zhvillohet në vijën e ruajtjes e të

---

<sup>1</sup> A. Kostallari, “Sur les traits principaux de l’albanais littéraire contemporain”. - *Studia albanica* 3/1966, 2, 3–30.

pasurimit të një forme gjuhësore bazë (dialekt i folur a letrar), që ajo përfaqëson një formë mbidialektore, e cila merr udhë dhe zhvillohet kryesisht mbi bazën e një dialekti a të një grupi të folmesh të afërta. Në këtë kuptim unë pajtohem me pikëpamjen që shqipja e sotme letrare përfaqëson një koine *sui generis*. Sigurisht, çdo formë gjuhësore e cilësuar si *koine* ka tipare specifike, që burojnë nga lënda, koha dhe rrethanat e mbrujtjes së saj, prandaj epiteti *sui generis* është vetvetiu i nënkuptueshëm për çdo koine tjetër pas koinesë së parë, që e bëri të njohur këtë term.

**I.** Pas këtij sqarimi terminologjik, le t'i hedhim një sy të shpejtë ecurisë së zhvillimit të shqipes letrare.

Formimi i shqipes standarde ka kaluar përmes një procesi ku kanë pasur ndikime përcaktuese rrethana historike, fetare, kulturore, d.m.th. jashtëgjuhësore, si edhe rrethana gjuhësore.

*Së pari*, tradita letrare relativisht e re e shqipes e shek. XVI e XVII (dy librat e parë të shek. XVI, përkatësisht 1555 e 1592) në rrethanat e vështira të periudhës osmane dhe të islamizimit masiv (shek. XVIII) gati u fashit; me Rilindjen Kombëtare Shqiptare në shek. XIX u desh që puna të niste nga e para në disa drejtime.

*Së dyti*, shqiptarët, një nga popujt e lashtë të Ballkanit, arritën të kenë një shtet të vetin që të funksiononte në gjuhën e vendit vetëm në fund të vitit 1912. Për këtë arsye dhe për shkak se Porta e Lartë nuk lejonte arsimin dhe botimet në gjuhën shqipe në katër vilajetet me popullsi shqiptare të Rumelisë, vatrat e lëvrimit të shqipes dhe të botimeve në gjuhën shqipe kanë qenë jashtë territorit të këtyre vilajeteve, kryesisht në kolonitë e mërgimtarëve shqiptarë (Stamboll, Rumani, Bullgari, Egjipt, SHBA etj.). Këtu duhet shtuar edhe tradita e begatshme e lëvrimit të shqipes te Arbëreshët e Italisë, sidomos gjatë shek. XIX.

*Së treti*, duke qenë se shqiptarët janë një popull me tri besime kryesore (myslimanë, të krishterë ortodoksë dhe të krishterë katolikë), veprimtaria dhe botimet fetare nuk mund të luanin rolin që kishin pasur te popujt tjerë në procesin e formimit e të përhapjes së gjuhëve të tyre letrare; në këtë mes duhet mbajtur parasysh edhe se shqipja e shkruar hyri me shumë vonesë në botimet dhe praktikatat e fesë islame (rreth 65–70% e popullsisë shqiptare), dhe iu desh të kapërcente në pengesa të mëdha për të hyrë në liturgjinë ortodokse.

*Së katërti*, gjendja kulturore në trevat shqiptare karakterizohej nga analfabetizmi masiv (edhe 15 vjet pas shpalljes së pavarësisë, më 1927, kur Shqipëria numëronte rreth 830.000 banorë, kishte vetëm 63.000 të shkolluar, nga arsimit fillor deri tek arsimit i lartë, d.m.th. 7,6%); krahas kësaj, në zhvillimin kulturor-arsimor të krahinave të ndryshme kishte shpërpjesëtime shumë të theksuara (78% e 63.000 të shkolluarve u përkisnin krahinave të jugut, d.m.th. të hapësirës së toskërishtes) dhe si pasojë në jetën letrare e në botimet krahinat u përfaqësuan në mënyrë tepër të pabarabartë. Në trevat

verilindore e lindore që u përfshinë në Mbretërinë Jugosllave pas vitit 1918, shqiptarët nuk kishin shkolla në gjuhën amtare dhe kështu nuk morën pjesë as në lëvizjen letrare.

*Së pesti*, gjatë periudhës osmane (shek. XVI–XIX) në zhvillimin e brendshëm të gjuhës shqipe kishin mbizotëruar prirjet divergjente: në dialektin e veriut (gegërishten) ndodhën një varg inovacionesh, ndërsa dialekti i jugut (toskërishtja) u tregua më konservator dhe ruajti në vija të përgjithshme gjendjen e kohës paraosmane. Kjo gjendje e dy dialekteve kryesore u pasqyrua edhe në gjuhën e shkruar të Rilindjes, që u mbështet kryesisht në gjuhën e folur të kohës, d.m.th. nuk vijoi traditën e qarkut letrar katolik të shek. XVI–XVII). Si pasojë morën zhvillim dy variante kryesore të shqipes letrare: varianti letrar i veriut (gegërishtja letrare) me dy nënvariate: njëri (më i zhvilluari) i mbështetur në të folmet veriperëndimore (i njohur edhe si *shkodranishtja letrare*), dhe tjetri, i mbështetur në të folmet e gegërishtes jugore (i njohur si *elbasanishtja letrare* dhe i përfaqësuar sidomos me përkthimet e K. Kristoforidhit (1827–1895): *Dhiata e Re* dhe pjesë nga *Dhiata e Vjetër*; krahas tyre, e ashtuquajtura *koine letrare toske* (ose *toskërishtja letrare*). Për këtë koine toske ka tërhequr vëmendjen që më 1909 Gjergj Pekmezi. Në kundërvënie me gegërishten letrare të kohës, që “ka për themel dialektin e Shkodrës” (se prej andej kanë dalë gjithë shkrimtarët dhe arsimtarët), në Toskëri “kanë dalë shkrimtarë prej disa këndeve të Toskërisë, e pandajza gjuha letrare e Toskërisë është një kullim jo vetëm i një dialektit të Toskërisë, po i disave.”<sup>2</sup>

Në studimet e sotme për formimin e shqipes letrare për këtë *koine* toske ka folur së pari edhe gjuhëtarja ruse A. V. Desnickaja<sup>3</sup>, duke vënë në dukje tri rrethana që kanë ndikuar për formimin e saj: relievi dialektor i toskërishtes (ose i dialektit të Shqipërisë jugore) është shumë më i butë se relievi dialektor i gegërishtes; mbi këtë bazë poezia popullore e jugut kishte arritur njëfarë *koineje* që u ofrohej si lëndë gjuhësore e gatshme poetëve e shkrimtarëve të shek. XIX, të cilët u mbështetën shumë te folklori; labërishtja dhe çamërishtja (si nëndialekte toske me disa tipare dalluese nga toskërishtja verilindore) nga gjysma e dytë e shek. XIX thujse nuk u përfaqësuan në gjuhën e shkruar si të tilla (autorët nga këto treva ndoqën përgjithësisht koinenë toske në format gramatikore e në fonetikë, por sollën fjalë e shprehje nga të folmet e tyre).

Në këto rrethana, që nga vitet '80 të shek. XIX, u shfaqën ide të ndryshme për mënyrën e formimit të një gjuhe letrare kombëtare të përbashkët për gjithë shqiptarët. Përveç ngritjes së njërit prej varianteve të mësipërme në rangun e

<sup>2</sup> Shih te *Diturija* (Selanik), Mot' i parë, 1 prill 1909, Nr. 4, f. 50. Të vihet re fjala *kullim*, e përdorur pak a shumë me kuptimin e termit *koine*.

<sup>3</sup> Pikëpamjet e saj i kam trajtuar tek artikulli “Rreth premisave të formimit të shqipes letrare në vështrimin e albanologes A. V. Desnickaja”. - *Perla* 19/2014, 1, 5-14.

një gjuhe letrare të përbashkët, pati edhe përpjekje për të eksperimentuar një përzierje formash dialektore geqe-toske e toske-geqe në gjuhën e shkrimit, në mënyrë që të dilte një variant letrar i pranueshëm e i kuptueshëm për të gjithë. Një ide tjetër joproduktive, gjithashtu si zgjidhje kompromisi, ishte krijimi i një forme letrare të re mbi bazën e një brezi të folmesh të quajtura *kalimtare* në Shqipërinë e Mesme, te të cilat ndërthuren elemente fonetike e morfologjike të gegërishtes e të toskërishtes.

Eruditi dhe filologu Sami Frashëri që i pari që pati idenë e rolit të një përqendrimi urban për formimin e një *koineje* (pa e cilësuar si të tillë). Asnjëri nga qytetet kryesore shqiptare në prag të shek. XX, sipas tij, nuk ishte i përshatshëm për t'u bërë kryeqytet i shtetit të ardhshëm të pavarur shqiptar. Prandaj duhej ndërtuar një qytet krejt i ri, diku në mes të Shqipërisë (në pllajën e bukur të Dumresë në jug të Shkumbinit), ku do të mblidhej një popullsi nga të gjitha anët e vendit, veçanërisht paria politike e kulturore, dhe nga përzierja gjuhësore që do të ndodhte atje, do të dilte gjuha letrare e përbashkët.

Shqipëria shpalli pavarësinë më 28 nëntor 1912 dhe u njoh ndërkombëtarisht si shtet i pavarur tetë muaj më pas. Në nëntor 1913 gjuha shqipe u shpall gjuhë zyrtare nga Qeveria e Vlorës, pa caktuar formën gjuhësore që do të përdorej. Siç dihet, Lufta I Botërore e ndërpreu jetën e shtetit të pavarur shqiptar dhe territori u nda ndërmjet ndërluftuesve: Italia kishte nën administrim qarkun e Vlorës dhe të Gjirokastrës, Franca qarkun e Korçës, ndërsa qarqet e tjera përbënin zonën austro-hungareze të administrimit. Fuqitë ndërluftuese njohën përdorimin e gjuhës shqipe në zonat e administruara prej tyre. Për zonën italiane dhe zonën franceze nuk dilte ndonjë problem shqetësues lidhur me formën gjuhësore: u përdor toskërishtja letrare me ngjyrimet e dialektit vendës. Në zonën austro-hungareze me kryeqendër Shkodrën kishte një larmi të folmesh që nga gegërishtja veriore, qendrore e jugore deri te toskërishtja veriore (pjesa nën Shkumbin e qarkut të Elbasanit, qarku i Fierit dhe i Beratit). Përballë autoriteteve austro-hungareze dilte nevoja e një forme gjuhësore të njëjtë me të cilën të punonin administrata, gjyqet dhe shkollat. Për të zgjidhur këtë çështje u thirr një komision letrar i posaçëm (1 shtator 1916 – nëntor 1918), i cili mori formën e një këshilli për të caktuar gjuhën letrare të shtetit shqiptar që do të ringrihej pas luftës. Komisioni kryesohej nga Dr. Gjergj Pekmezi (toskë nga Pogradeci, docent i gjuhës shqipe në Universitetin e Vjenës), disa anëtarë të tij vinin nga krahinat nën administrimin italian e francez, pra ishte një forum mbarëkombëtar. Autoritetet austro-hungareze ishin më fort të interesuara për një zgjidhje të shpejtë, sesa cila do të ishte zgjidhja. Kuptohet vetvetiu se tradita letrare shkodrane do të ndikonte shumë në punën e këtij komisioni. Por komisioni u orientua jo aq nga prodhimi letrar, sesa nga përshtatshmëria gjuhësore, së pari për zonën austro-hungareze të administrimit, por edhe më gjerë. Kështu, pas disa diskutimesh u pranua propozimi i Luigj Gurakuqit për të marrë si bazë të gjuhës letrare në

vija të përgjithshme elbaskanishten, e cila kishte fituar njohje e prestigj me përkthimet e biblës gegërisht prej Kostandin Kristoforidhit. Në komision mori pjesë edhe albanologu vjenez Dr. Max Lambertz, i cili në fillim qe shprehur për shkodrarishten letrare, por pas hulumtimeve në terren u pajtua me propozimin e L. Gurakuqit.

Në të vërtetë, me këtë zgjidhje më fort u la mënjanë forma gjuhësore e traditës letrare shkodrane, e cila me veçoritë e saj karakteristike nëndialektore paraqitej e vështirë jo vetëm për shqiptarët e jugut, por edhe për ata të krahinave të tjera të veriut. Dialekti i Elbasanit (gegërishtja jugore) u vështrua si një urë lidhëse ndërmjet arealit të gegërishtes në veri dhe arealit të toskërishtes në jug. Rregullat që u caktuan (sidomos drejtshkrimi), pasqyronin gjendjen e gegërishtes letrare tek autorët e shek. XVI–XVII, para se të përhapeshin inovacionet e saj, d.m.th. kur ajo ishte shumë më e afërt me toskërishten (ruheshin grupet e bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*, *ng*, *ngj*, bashkëtingëllorja *nj*, grupet e zanoreve *ie*, *ye*, *ue*, zanorja *ë* e patheksuar në trup e në fund të fjalës). Një prirje e tillë ishte vërejtur në gegërishten e shkruar që nga fundi i shek. XIX. Në këtë mënyrë, forma gjuhësore që u caktua, duke qenë gegërishte në tiparet themelore fonetike e morfologjike, u afrua dukshëm në drejtshkrim me toskërishten. Për këtë puna e komisionit të mbledhur në Shkodër është vlerësuar pozitivisht. Ky variant letrar i Komisionit të Shkodrës u përkrah nga një kongres arsimor i mbledhur në Lushnjë në gusht 1920 për t’u përdorur në veprimtarinë shkollore, duke përfshirë edhe hartimin e teksteve. Qeveria shqiptare, me një dekret të janarit 1923, caktoi atë si “dialekt zyrtar i shtetit” dhe kështu njësoi gjuhën e administratës. U krijua kështu një lloj *burokratishteje*, e detyrueshme për administratën, por pa një kodifikim të përcaktuar<sup>4</sup>. Për këtë arsye ajo interpretohej dhe zbatohet me luhajtje të shumta (sipas prejardhjes dialektore dhe arsimit të nëpunësve). Kjo gjendje vijoi edhe gjatë viteve të luftës (1939–1944). Ndërkaq letërsia dhe publicistika nuk u orientuan drejt të quajturit “dialekt zyrtar i shtetit”, por ashtu si më parë u shkruan në një masë të madhe në koinenë toske dhe në gegërishten letrare me variacionet e saj (jo vetëm në Shqipëri, por edhe në diasporë)<sup>5</sup>. Tekstet shkollore hartoheshin në dialektin e autorit; abetarja ishte gegërisht për krahinat e veriut edhe toskërisht për krahinat e jugut (kjo praktikë vijoi edhe në vitet e para pas mbarimit të luftës). Mësuesit kanë folur në dialektin e vet ose me infleksione të theksuara dialektore dhe kjo praktikë ende nuk mund të quhet e kapërcyer. Kështu në periudhën ndërmjet dy luftërave dhe në vitet e pushtimit

<sup>4</sup> Lidhur me këtë mjafton të kujtojmë se deri më 1954 nuk ka pasur një fjalor shpjegues shqip, që të shërbente edhe si udhëzues drejtshkrimor.

<sup>5</sup> Deri në shpërbërjen e Mbretërisë Jugosllave (prill 1941) shqiptarëve që jetonin në trevat e aneksuara prej saj pas Luftës I Botërore, nuk u lejohej të kishin shkolla dhe botime në gjuhën e vet.

italo-gjerman varianti letrar i komisionit të Shkodrës, i adoptuar nga shteti si “dialekt zyrtar” nuk arriti të bëhej strumbullari i një gjuhe letrare shqipe të përbashkët e të njësuar, por shërbeu për zbutjen e veçorive gjuhësore të gegërishtes së shkruar dhe për afrimin e saj me toskërishten.

Në këtë mes le të kujtojmë se dallimet ndërmjet gegërishtes e toskërishtes, sidomos si variante letrare, nuk janë aq të forta sa të pengojnë marrëveshjen. Për ta thënë me fjalët e M. Lambertz-it, *vetëm suvaja është e ndryshme, por muri prapa saj është i njëjti*. Veprat letrare dhe të tjera gegërisht janë kuptuar e shijuar pa vështirësi të madhe nga lexuesit toskë, dhe po ashtu veprat e autorëve toskë janë kuptuar e shijuar nga lexuesit e arealit të gegërishtes. Kontaktet e dendura ndërmjet Jugut e Veriut sidomos në periudhën e pasluftës, bënë që shumica e shqiptarëve të ishin të paktën zotërues pasivë të dialektit tjetër.

Në këtë kuadër është e nevojshme të mbahet parasysh se në Shqipëri, në përfundim të Luftës II Botërore, mbi 80% e burrave dhe mbi 90% e grave ishin analfabetë (me një popullsi prej 1.120.000 banorësh, nga e cila vetëm 16% me banim në qytet); arsimi fillor mungonte në shumë zona rurale malore, arsimi i mesëm ishte i përqendruar në 8–9 qytete, ndërsa për ndonjë shkollë të lartë a universitet nuk bëhej fjalë. Këto rrethana e kanë vështirësuar shumë formimin e një gjuhe letrare të përbashkët. Kështu që realizimi i kërkesës për një shqipe letrare kombëtare të përbashkët (*standarde* me terminologjinë e sotme) i mbeti periudhës së pasluftës, d.m.th. viteve të sistemit socialist. Si anëtarja më e prapambetur e “familjes së vendeve socialiste” (siç quhej atëherë), Shqipëria duhej të ecte me hapa të shpejtë për t’u afruar me të tjerët dhe si rrjedhim, krahas arritjeve në fushën e ekonomisë, u shënuan përparime të mëdha edhe në fushën e arsimit e të kulturës. Por më parë dua të tërheq vëmendjen për një statistikë të gjendjes kulturore-arsimore të vendit më 1927 (15 vjet pas shpalljes së pavarësisë):

	Me universitet	Me shkollë të mesme	Me shkollë fillore	Për studime Jashtë	Gjithsej të shkolluar
<b>Veriu</b>	45 (10%)	229 (13%)	13013 (22%)	252 (32%)	13.539 (22%)
<b>Jugu</b>	402 (90%)	1544 (87%)	46869 (78%)	535 (68%)	49.350 (78%)
<b>Vendi</b>	<b>447</b>	<b>1773</b>	<b>59.882</b>	<b>785</b>	<b>62.889</b>

**Popullsia e vendit gjithsej (1927): 828. 593 banorë**

**Analfabetë: 828.593 – 62.889 = 765.704 banorë ose 92,40%**

Nga kjo pasqyrë del se katër prefekturat e jugut (Gjirokastra, Korça, Vlora dhe Berati) më 1927 kishin 90% të universitarëve, 87% të atyre me shkollë të mesme, 78% të atyre me shkollë fillore, 68% të studentëve jashtë vendit, d.m.th. 78% të të shkolluarve (62.889). Gjashtë prefekturat e veriut (Tirana, Elbasani, Durrësi, Dibra, Shkodra, Kukësi) kishin pjesën tjetër. Ky shpërpjesëtim erdhi duke u zbutur, por gjithsesi me ritme të ngadalta. Pasqyra e mësipërme shpjegon pse grupi drejtues qoftë i Lëvizjes Nacionalçlirimtare (e udhëhequr nga komunistët), qoftë i Ballit Kombëtar (i udhëhequr nga nacionalistët antikomunistë) në pjesën më të madhe vinte nga krahinat e jugut, d.m.th. nga hapësira e toskërishtes: për t'u marrë me politikë duhet të jesh i shkolluar. Të dyja këto forca politike në propagandën dhe veprimtarinë e tyre gjatë luftës nuk e përfillën “dialektin zyrtar të shtetit”. Pas luftës dekreti qeveritar i vitit 1923 u quajt i paqenë ose i shkelur nga koha dhe ndodhi ajo që mund të quhet “rëshqitje e butë” drejt toskërishtes letrare, sepse ajo ishte dialekti amtar i shumicës së të shkolluarve<sup>6</sup>.

Me gjithë vendimet për të përdorur toskërishten në administratën e shtetit dhe në sistemin arsimor, procesi eci shkallë-shkallë, pa shtrengime – shteti kishte shqetësime të tjera më të mëdha dhe nuk u angazhua shumë për vendosjen dhe zbatimin e detyrueshëm të një forme gjuhësore të njëjtë e të përcaktuar për administratën. Por kërkesa për zgjidhjen e çështjes gjuhësore dhe orientimet për këtë nuk munguan, siç ishte rasti i fjalës së ministrit të Drejtësisë Manol Konomi, njëkohësisht kryetar i Institutit të Studimeve (më pas Instituti i shkencave) në themelimin e atij Instituti, që dha orientimin se: “Zhvillimi i gjuhës duhet të ndjekë zhvillimin e procesit politik dhe shoqëror të popullit.”<sup>7</sup> Sidoqoftë deri në vitet '70 gjendja mund të cilësohet si “liberalizëm

<sup>6</sup> Por nuk duhet lënë mënjanë ndalimi i botimit i organeve kulturore e fetare katolike të Shkodrës “Hylli i Dritës”, “Leka”, “Zani i Shna Ndout” me mjaft ndikim në shtresën intelektuale katolike, por edhe më gjerë.

<sup>7</sup> Ja një pjesë nga fjala e tij në emër të qeverisë në themelimin e Institutit të Studimeve: “Instituti i Studimeve duhet t'arrijë në disa konkluzione, që janë të nevojshme për zhvillimin e gjuhës dhe të letërsisë sonë. Është çështja për formimin e një gjuhe letrare të përbashkët. Në lidhje me këtë Instituti do të punojë Fjalorin, ortografinë e gjuhës, duke marrë si bazë fonetikën e saj, dhe gramatikën e gjuhës shqipe.

Gjuha është një fenomen shoqëror. Ajo u shtrohet ligjeve shoqërore. Zhvillimi i saj lidhet me procesin historik të shoqërisë. Bashkimi moral e politik i popullit shqiptar kërkon krijimin e një gjuhe të përbashkët kombëtare. Zhvillimi i gjuhës jo në një drejtim të caktuar, po në drejtime të ndryshme bëhet pengesë e madhe në bashkimin e popullit. Dhe çdo gjë që pengon këtë bashkim, duhet të eliminohet.

Nuk mund të mohohet se regjimet reacionare të djeshme nuk kishin ngritur midis krahinave të ndryshme barrikada linguistike. Një gjuhë, që lihet e lirë t'u shtrohet

gjuhësor”: jo vetëm në letërsinë artistike, por edhe në botimet shkencore (madje edhe në Institutin e Historisë dhe të Gjuhësisë) mund të përdreshin lirisht variantet letrare të gegërishtes; gjithashtu në veprimtarinë shkencore në administratën e qarqeve të veriut përdorej shpesh gegërishtja. “Fjalori i gjuhës shqipe” (1954) – i pari fjalor shqip-shqip – ndonëse shpjegimet i ka në dialektin e jugut, është i mbushur me forma fjalësh të dialektit të veriut si *dhelapën, dhelapni, kambë, ranë, grani* etj., që referohen te format përkatëse të toskërishtes *dhelapër, dhelapëri, këmbë, rërë, grari*; edhe udhëzuesit drejtshkrimorë të viteve 1948, 1951, e 1956 përmbanin rregulla të veçanta për format e gegërishtes.

Gjuhëtari Kostaq Cipo (1892–1952) nga Elbasani (adhurues i poetit Naim Frashëri), kur u ngarkua më 1948 nga Instituti i Shkencave që të hartonte një gramatikë të gjuhës shqipe, nuk mori ndonjë udhëzim se në ç’dialekt duhej ta punonte gramatikën. Ashtu si paraardhësi e bashkëqytetari i tij i shquar Kostandin Kristoforidhi, edhe K. Cipoja nuk zgjodhi dialektin e vet amtar, gegërishten e Elbasanit, por toskërishten. Arsyetimi i tij për këtë zgjedhje përmbledhet në këto pika: toskërishtja është idioma e rilindjes sonë letrare, gjuha e Naim Frashërit dhe e atyre që ndoqën shembullin e tij; toskërishtja është gjuha që u përdor më shumë gjatë luftës antifashiste dhe më pas; qendra më e madhe e zhvillimit të toskërishtes është sot në Tiranë, ku ajo “do të fitojë tërë ç’i duhet për të shkruar në njësi harmonike divergjencat që lindin nga zhvillimet gjuhësore” për hir të një procesi *shkrahinarizimi* dhe *përgjithësimi*

interesave të ndryshme, një ditë është e destinuar të bjerë në dekadencë. Zhvillimi i gjuhës duhet të ndjeki zhvillimin e procesit politik dhe shoqëror të popullit.

Duhet të jemi të qartë. Gjuha letrare, gjuhë e përbashkët kombëtare duhet të jetë ajo e masave të popullit, që përfaqësojnë pjesën më progresive të vendit tonë. Rruga që çeli populli me luftën e tij, duhet të jetë rruga që duhet të ndjeki edhe gjuha në zhvillimin e saj. Zhvillimi i gjuhës në një drejtim tjetër ose në një drejtim të kundërt nuk është i mundshëm. Ky është kriteri i shëndoshë që duhet të kemi gjithnjë përpara në punën tonë.

Pse një shkrimtar ka shkrojtur në këtë ose atë gjuhë, pse një vepër ose një seri veprash janë shkrojtur në këtë dialekt ose në një dialekt tjetër, nuk janë shkaqe determinante për të imponuar këtë ose atë dialekt. Vetëm në të kaluarën lejohej zhvillimi i një lufte rreth këtyre kriterëve. Sot çështja duhet të preket dhe të zgjidhet ndryshe. E kaluara këtu, më shumë se kudo gjetkë, ka lënë gjurmë të thella. Forca e zakonit këtu do të jetë më e fortë.” (*Buletin i Institutit të Studimeve*”, viti I, 1947, nr. 1, f. 18–19). [Manol Konomi (1910–2002) nga pakica greke e Poliçanit të Pogonit, jurist i diplomuar në Universitetin e Tuluzës, ministri i parë i Drejtësisë i qeverisë komuniste (1944–1951), kryetar i Institutit të Shkencave (1947–1951). Kam pasur rastin të bisedoj me të pas kthesës politike dhe më ka pohuar se fjalën e mbajtur në inaugurimin e Institutit të Studimeve e kishte shkruar me dorën e vet, por ia kishin kërkuar për ta parë në aparatën e Komitetit Qendror; ia kishin kthyer pa ndonjë vërejtje a kërkesë për të shtuar diçka].

(termat e tij – E.L.). Me fjalë të tjera, ky themelvënës i gjuhësisë normative të shqipes, parashikonte që Tirana, me rritjen e shpejtë të popullsisë nga krahina të ndryshme dhe me përqendrimin e institucioneve shtetërore, arsimore e kulturore, do të bëhej fusha e ndeshjes së idiomave dialektore të folura. Kjo do të sillte si rrjedhim *shkrahinarizimin*, d.m.th. humbjen e veçorive të ngushta dalluese krahinore, duke përgjithësuar format e përbashkëta. E shprehur me një terminologji tjetër, kjo mund të quhet krijimi i një *koineje mbidialektore*, e cila me kohë merr shtrirje kombëtare, bëhet formë e përbashkët e gjuhës së shkruar dhe të folur<sup>8</sup>.

Kostaq Cipoja, që u nda nga jeta në ditët e para të vitit 1952, mundi ta përkapte me mprehtësi këtë proces që në fillimet e tij. Ky proces eci me ritme më të shpejta sidomos nga fundi i viteve '50, kur u themelua Universiteti i Tiranës (1957), dhe në vitet '60, kur u zgjerua arsimi i lartë, arsimi i mesëm u shtri në gjithë vendin dhe u forcua sistemi arsimor, u krye elektrifikimi i plotë, u shtua popullsia e qyteteve dhe u ndërtuan qytete të reja, u shtuan shumë botimet dhe organet e shtypit, nisi punën edhe televizioni shqiptar (në formë eksperimentale më 1960).

Në vitet '60 në Institutin e Gjuhësisë filloi puna përgatitore për një fjalor të madh të gjuhës shqipe dhe për një gramatikë përshtuese të tipit akademik. Këto projekte dhe kërkesat nga institucionet arsimore dhe entet botuese bënë të domosdoshme rishikimin dhe plotësimin e udhëzuesit drejtshkrimor të vitit 1956<sup>9</sup>. Udhëzuesi i ri, i botuar si projekt për diskutim masiv më 1967<sup>10</sup>, u hartua nën drejtimin e prof. Androkli Kostallarit. Ai në ato vite kishte formuluar edhe tezën sipas së cilës që atëherë *ekzistonte në thelb një gjuhë e vetme letrare shqipe me prirje të qarta zhvillimi, e cila ndodhej në fazën e kristalizimit përfundimtar të normës së saj dhe funksiononte në të gjitha sferat e marrëdhënieve midis njerëzve; në pjesën dërrmuese të strukturës fonetiko-gramatikore, fjalëformuese e leksikore të kësaj gjuhe letrare zotëronte tashmë*

<sup>8</sup> Shih më gjerë: Emil Lafe. “Prof. Kostaq Cipo themelues i gjuhësisë normative shqiptare”. - *Perla* 18/2013, nr. 2, f. 17–25; *Kostaq Cipo personalitet i gjuhësisë shqiptare. Përmbledhje e materialeve të Konferencës shkencore ndërkombëtare “Kostaq Cipo personalitet i gjuhësisë shqiptare”, mbajtur në Elbasan, më 22 qershor 2012*. Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan & Qendra e Studimeve Albanologjike Tiranë. “Pegi”, Elbasan, 2015, f. 15–21.

<sup>9</sup> “Ortografia e gjuhës shqipe”. Komisioni: Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Androkli Kostallari dhe Mahir Domi. – *Buletin për shkencat Shoqërore* 10/1956, nr. 4, fq. 38–65.

<sup>10</sup> *Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (Projekt)*. Komisioni hartues: Androkli Kostallari, Eqrem Çabej, Mahir Domi, Emil Lafe (asistent). Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1967, 214 f.

*një normë e vetme*<sup>11</sup>. Në pajtim me këtë, në projektin e drejtshkrimit nuk u formuluan më rregulla edhe për gegërishten letrare, por mbetën në fuqi rregullat e mëparshme për ata që do të donin ta përdornin.

Lidhur me *akceptimin*<sup>12</sup> e gjuhës letrare të njësuar në Shqipëri dëshiroj të shtoj edhe disa vëzhgime të miat. Një pjesë e madhe e arealit gjeografik të gegërishtes deri në vitet '50–'60 ka qenë e paurbanizuar. Qytetet e sotme si Kukësi, Kruma, Bajram Curri, Tropoja, Fushë-Arësi, Puka, Rrësheni, Kurbneshi, Rubiku, Peshkopia, Bulqiza, Burreli, Lezha, Miloti, Laçi, Mamurrasi, Fushë-Kruja kanë qenë qendra të vogla banimi (një pjesë edhe me tiparet e një fshati. Të folmet geqe të asaj hapësire kanë mjaft dallime nga gegërishtja letrare si në inventarin, ashtu edhe në tiparet e fonemave. Ato të folme nuk kanë prodhuar ndonjë traditë letrare. Kjo rrethanë, bashkë me përqindjen e lartë të analfabetizimit (mbi 90%) bënë që gjuha e administratës, e shkollës, dhe e mediave me bazë toskërishten në vitet e pasluftës të shihej si e vetmja formë gjuhësore letrare dhe të akceptohej pa diskutime. Brezat e rinj të njerëzve të letrave dhe të jetës publike që dolën nga ato zona, kaluan në mënyrë të natyrshme e të vetvetishme nga dialekti amtar në gjuhën letrare të shkollës, pa ngurrime dhe pa sakrifikuar ndonjë traditë letrare të mëparshme. Qyteti i Durrësit, ashtu si edhe Tirana, të dy në hapësirën e gegërishtes, patën një shumëfishim mekanik të popullsisë me të ardhur nga të gjitha krahinat, por sidomos nga krahinat e jugut, që pësuan më shumë nga operacionet e luftës. Në këto dy qytete popullsia e vjetër vendëse “u përmyt” nga të ardhurit, të cilët nuk gjetën aty ndonjë traditë kulturore e letrare të qëndrueshme, të krijuar mbi idiomën vendore. Edhe këtu përhapja dhe përdorimi i variantit letrar zyrtar rrodhi në mënyrë të qetë e të natyrshme. E folmja vendore u kufizua në ligjërimin e përditshëm bisedor dhe me kohë u kthye në një lloj emëruesi të përbashkët për komunikimin e përditshëm jashtë familjes, sidomos te shtresat pa shumë interesa kulturore. Kjo merrte herë-herë edhe kuptimin e një kundërvënijeje ndaj gjuhës së thatë të propagandës ideologjike dhe të burokracisë.

<sup>11</sup> Androkli Kostallari. “Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare”. - *Shkencat shoqërore në shkollë*, 1967, nr. 2, f. 71–70.

<sup>12</sup> Kam parasysh këtu pohimin e albanologut austriak Hermann Ölberg: “Si jo-shqiptar nuk kam të drejtë të fus hundët në këtë çështje delikate, por, duke e ndjekur me vëmendje zhvillimin e gjuhës së njësuar gjatë tri dekadave, kam krijuar përshtypjen se gjuha e njësuar është *akceptuar si normë*.” (kursivi imi – E.L.) – në artikullin e shkruar shqip prej tij “Disa mendime rreth “gjuhës së njësuar”, në: *Qvo vadis, Shqipëri? Antologji e përgatitur nga Ardian Klosi*. Botime Albania. München 1993, 22–25.

Një pozitë të veçantë pati në këtë mes Shkodra<sup>13</sup>, jo vetëm qyteti më i madh në fillimet e shtetit të pavarur shqiptar, por edhe qendër kulturore-arsimore me traditë të pasur. Atje ishte përpunuar dhe zhvilluar një varietet letrar mbi bazën e së folmes së qytetit dhe të gegërishtes veriperëndimore në përgjithësi, i njohur si shkodranishtja letrare. Shkodra ishte njëkohësisht edhe qendra e katolicizmit shqiptar, i përhapur kryesisht në atë hapësirë dialektore. Në këto rrethana dhe në kushtet e një analfabetizmi mbi 90%, një formë gjuhësore deri diku e ndryshme nga ajo që përdorej tradicionalisht që nga mesi i shek. XIX me vendosjen e etërve jezuitë, të cilët e lanë mënjanë traditën shkrimore të autorëve të shek. XVII, si Pjetër Budi e Pjetër Bogdani (gjuha e tyre ka qenë mjaft më e afërt me toskërishten sesa gegërishtja veriperëndimore e shek. XIX) dhe krijuan një traditë shkrimi sipas idiomës popullore të kohës<sup>14</sup>, nuk do të ishte fort e mirëseardhur në atë areal. Shkodranishtja letrare u ngulit edhe më thellë në vetëdijen kulturore të popullsisë së shkolluar të qytetit me ngritjen e shkollave shtetërore pas pavarësisë dhe të shkollave të mëparshme ose të reja fetare (katolike), që ndiqeshin edhe nga nxënës myslimanë. Edhe pas vendosjes së pushtetit komunist, deri nga fundi i viteve '60, në Shkodër lulëzoi një letërsi pak a shumë në idiomën vendëse dhe po ashtu teatri i qytetit e krahas tyre edhe botimet shkencore, si “Buletini shkencor” i Institutit të Lartë Pedagogjik (i themeluar në të njëjtin vit me Universitetin e Tiranës – 1957), almanaku letrar-kulturor “Shkodra” etj. Ashtu si në krahina të tjera, edhe në Shkodër, gjuhë e folur në administratën vendore dhe në shkollë ishte kryesisht e folmja e krahinës. Me të gjitha këto mendoj se shpjegohet pse pikërisht në mjedisin shkodran u shfaqën edhe reagimet e para ndaj gjuhës së njësuar në fillim të viteve '90.

Tani është e nevojshme të hedhim një vështrim edhe për gjuhën shqipe jashtë shtetit shqiptar. Për shqiptarët në shtetin jugosllav u hapën shkolla në gjuhën shqipe vetëm më 1941, pas shpërbërjes së Mbretërisë Jugosllave<sup>15</sup>. Në Federatën Jugosllave këto shkolla vijuan dhe krahas tyre u zhvillua shtypi dhe letërsia në gjuhën shqipe, u shtuan shkollat e mesme, më 1960 u hap në Prishtinë Fakulteti Filozofik (si degë e Universitetit të Beogradit), disa shkolla

---

<sup>13</sup> E vetmja qendër vilajeti nga koha e Perandorisë Osmane, që mbeti brenda kufijve të Shqipërisë.

<sup>14</sup> I Padri gesuiti che vennero allora a Scutari erano quasi tutti italiani, perciò cominciarono a scrivere nella lingua del popolo, voltando le spalle al purismo e all'arcaicità della lingua e questo anche perché essa era l'unica che apprendevano e potevano perfezionare e completare attraverso i quotidiani contatti con la popolazione (Namik Ressuli, *Grammatica albanese*. Patron editore. Bologna 1985, Introduzione, f. XXX).

<sup>15</sup> Sot popullsia shqiptare në Republikën e Kosovës dhe në territoret e tjera në ish Jugosllavinë Federative arrin në mbi tre milionë banorë.

të larta pedagogjike dhe më 1970 Universiteti i Prishtinës. Shqipja e Kosovës dhe e disa trevave të tjera rreth saj përbëjnë degëzimin verilindor të dialektit të gegërishtes. Ky dialekt nuk prodhoi një traditë letrare, prandaj atje pas vitit 1941 e në vijim në të gjitha funksionet u përdor kryesisht ajo që e quajtmë *elbaskanishtja letrare* ose gegërishtja e mesme. Në Jugosllavinë e atëhershme ky varietet letrar njihej zyrtarisht si *shiptarski jezik*, ndërsa shqipja e Shqipërisë si *albanski jezik* dhe bashkë me këtë bëhej dallimi *albanci* “shqiptarët e Shqipërisë” dhe *shiptari* “shqiptarët e Jugosllavisë”. Marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë e Jugosllavisë u ndërpre në verën e vitit 1948. Në Kosovë nga viti 1952 pati përpjekje të organizuara për të përpunuar një udhëzues drejtshkrimor sa më të përshtatshëm. Bashkëpunimi me gjuhëtarët në Shqipëri ishte i pamundur, por udhëzuesit drejtshkrimorë të botuar në Tiranë më 1948, 1952 e 1956, ndikuan që norma drejtshkrimore e përpunuar në Kosovë të afrohej me atë të Tiranës.

Botimi i projektit të drejtshkrimit në Tiranë ndodhi në një klimë politike pak më të lehtësuar për shqiptarët në Jugosllavi dhe u lejua ribotimi i tij në Prishtinë. Kjo dha shkas që të mblidhej një konsultë gjuhësore e shqiptarëve në Jugosllavi (Prishtinë, 22–24 prill 1968). Konsulta vendosi të adoptojë gjuhën letrare të shtetit amë (sipas parimit “Një komb – një gjuhë letrare kombëtare”) dhe të vërë në zbatim menjëherë rregullat e projektit të Tiranës. Kështu gegërishtja letrare e zbatuar në Kosovë dhe në përgjithësi te shqiptarët në Jugosllavi doli nga përdorimi publik. Kjo pati si pasojë që edhe në Shqipëri autorët që vijonin lirisht të shkruanin gegërisht (letërsi artistike ose studime shkencore) ta ndërprisnin vetë atë praktikë pa ndonjë vendim a porosi administrative. Kështu ndodhi, papritur, njësimi i praktikës gjuhësore te shqiptarët andej e këtej kufirit. U realizua bashkimi gjuhësor i *membra disjecta*, nëse mund ta quajmë kështu. Pas katër vjet diskutimesh për projektin e drejtshkrimit, por pa e vënë asnjëherë në diskutim njësimin gjuhësor të arritur, u mblodh Kongresi i Drejtshkrimit (Tiranë, 20–25 nëntor 1972), që sanksionoi atë arritje dhe përcaktoi drejtimitet e përpunimit përfundimtar të drejtshkrimit.

Në arritjen e kësaj zgjidhjeje ndikuan një varg faktorësh, sidomos kulturorë e arsimorë. Shqipja e sotme standarde përfaqëson një zhvillim organik të koinesë letrare toske, e cila përthithi elemente të rëndësishme heterodialektore, veçanërisht në vitet ’50–’60, duke u shndërruar nga një koine brenda dialektit të jugut, në një koine me elemente edhe prej dialektit të veriut. Ndërsa variantet letrare të gegërishtes (shkodranishtja dhe varianti i mesëm) gjatë zhvillimit të tyre nuk arritën të përthithnin e të pasuroheshin me elemente të toskërishtes. Afrimi i tyre me toskërishten letrare, kryesisht në rrafshin fonetik, u realizua përmes rikthimit të format e përbashkëta të dëshmuara tek autorët gegë të shek. XVI e XVII dhe me pranimin e pjesshëm të mosshënimit të gjatësisë e të hundorësisë, sipas alfabetit të Manastirit (1908).

Përmes një procesi përzgjedhjeje në praktikën gjuhësore dhe *shkrahinarizimi* (K. Cipo), u kristalizua në vija të përgjithshme forma e sotme e gjuhës letrare dhe norma e saj, e cila u materializua në veprat normative që u botuan pas Kongresit të Drejtshkrimit: “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, “Fjalori drejtshkrimor”, “Fonetika dhe gramatika e gjuhës shqipe”, “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”. Në Tiranë u mbrujt tipi gjuhësor i pamarkuar fonetikiisht me ngjyrimet dialektore të jugut a të veriut dhe i pranuar si formë letrare e të folurit shqip.

Në këtë zgjidhje, sipas pikëpamjes sime, faktori shtet ka ndikuar si faktor i rendit kulturor, d.m.th. është përkrahur ecuria e procesit gjuhësor në zhvillim e sipër, që mbështetej në gjendjen arsimore-kulturore të popullsisë dhe në traditën e pasur të lëvrimin të toskërishtes gjatë Rilindjes dhe më pas. Rasti i formimit të shqipes standarde i përket tipit të zgjidhjes mbi bazën e kombinimit të faktorit brendagjuhësor (njëtrajtësia më e madhe e bazës dialektore, arritja e një koineje toske përballë një koineje të munguar gege) me faktorin kulturor (numri më i madh i pjesëmarrësve në procesin letrar dhe tradita më e frytshme e lëvrimin mbi bazën dialektore të dhënë), të përkrahur nga faktori shtet. Që më 1905 Aleksandër Xhuvani qe shprehur se toskërishtja duhej marrë “për themel mbi të cilin të ndërtojmë gjuhën tonë letrare” dhe “atje ku toskërishtja nuk e mbush dot qëllimin, le t’i vijë ndihmëtare gegërishtja.” Si epërsi të toskërishtes ai vinte në dukje se sintaksa e saj është më e kthjellët, fonetika më tingëllore e më harmonike, fjalët janë më të gjera e më rrumbullake e jo fort të shkurtra<sup>16</sup>. Edhe nga kjo mund të kuptohet qartë se në zhvillimin e gjuhës letrare shqipe nuk ka ndodhur ndonjë kthesë e rreptë, e papritur, ndonjë devijim i detyruar dhunshëm i procesit të zhvillimit konvergjent të gjuhës letrare nga shtrati i tij i natyrshëm.

Pas vendosjes së pluralizmit politik, siç pritej, pati një valë kundërshtimesh e kontestimesh për zgjidhjen e Kongresit të Drejtshkrimit. Iu mëshua shumë rrethanës se hapësira gjeografike që mbulon gegërishtja (dialekti i veriut) është më e madhe se ajo që mbulon toskërishtja (dialekti i jugut). Por pak nga pak u kuptua dhe po kuptohet se as hapësira më e madhe gjeografike e një tipi dialektor e as numri më i madh i popullsisë nuk janë faktorë vendimtarë në përzgjedhjen e bazës dialektore të një gjuhe letrare. U bë e qartë se ajo që qe arritur, ka qenë edhe zgjidhja më e mirë, në rast se nuk duam të rikthehet gjendja me dy variante letrare.

---

<sup>16</sup> Aleksandër Xhuvani, “Për themelim të një gjuhe letrëtare”. *Vepra I*. Akademia e Shkencave e RPSH. Tiranë, 1980, f. 6 e 5. Për hir të së vërtetës duhet thënë se A. Xhuvani (1880–1961) në gjithë veprimtarinë e vet i ndenji besnik (por me luhatje të shumta drejtshkrimore e morfologjike), idiomës së tij amtare elbasanase, duke shpresuar se pas vendimit të Komisionit të Shkodrës ajo mund të ngrihej në shkallën e një gjuhe të përbashkët, ndryshe nga nipi i tij Kostaq Cipo (12 vjet më i ri), që iu drejtua toskërishtes dhe hartoi gramatikën normative të saj (1949).

II. Le t'i hedhim tani një vështrim të shpejtë strukturës fonetike e morfologjike të shqipes standarde, duke e ballafaquar me dy dialektet.

### Tingujt

1. Struktura fonetike e shqipes standarde është përcaktuar që me alfabetin e Shoqërisë së Stambollit më 1879<sup>17</sup> me 7 zanore gojore (*a, e, ë, i, o, u, y*) dhe 29 bashkëtingëllore. Tipar relevant është mbështetja në sistemin fonetik të toskërishtes së mirëfilltë (ose verilindore), d.m.th. treva ndërmjet lumenjve Vjosë (në perëndim) e Shkumbin (në veri), e cila ka ruajtur gjendjen e përbashkët të dy dialekteve në shekujt e parë të dokumentimit të gjuhës shqipe (shek. XVI – fillimi i shek. XVIII). Që në kapërcyell të shek. XX gegërishtja e shkruar po shkëputej nga risitë fonetike të ligjërimin dialektor (monoftongimi i grupeve të zanoreve *ie, ye, ue* në *ī, ȳ, ū* dhe asimilimi i grupeve të bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng, ngj*) dhe po i drejtohej traditës së autorëve të vjetër gegë, që pajtohej me toskërishten e folur e të shkruar, duke ruajtur të plota në shkrim grupet *ie, ye (diell, ziej; fyell, lyej* (të përbashkëta për të dy dialektet), grupin *ue (grue, shkuem* etj.), të cilit në toskërishte i përgjigjet *ua (grua, shkuam* etj.) dhe grupet bashkëtingëllore të sipërpërmendura (p.sh. *mbush, nder, tund, nga, beng, ngjyey* etj.).

Në sistemin e zanoreve të shqipes standarde, në krahasim me gegërishten, si tipare relevante dalin: zanorja *ë* e theksuar para hundoreve (në vend të *a* të gegërishtes: *këmbë - kambë, ëndërr - andërr* etj.); mungesa e serisë së zanoreve hundore; gjatësia e zanoreve nuk luan rol fonologjik dhe nuk shënohet (ashtu si në alfabetin e Shoqërisë së Stambollit); grupi zanor *úa: grua, luaj* etj. në vend të *ue* të gegërishtes në paradigmën e emrave e të foljeve dhe njëkohësisht integrimi i grupit *ue* nëpërmjet klasave të emrave (*nomina agentis*) dhe mbiemrave të prejardhur nga tema foljore më zanore: *mësues, përçues, i besueshëm* etj.), që kanë mënjeluar formimet e toskërishtes, si *mësonjës, përçonjës, i besuarshim*). Grupet *ie, ye (diell, ziej; fyell, lyej* janë të përbashkëta për të dy dialektet, por në gegërishten e folur sot përgjithësisht dalin të monoftonguara në *ī, ȳ*), ndërsa gjuha standarde i ruan të plota sipas toskërishtes.

Në sistemin e bashkëtingëlloreve tipare dalluese relevante të standardit në raport me dialektet janë: rotacizmi përballë mungesës së tij në gegërishte (*gruri - gruni, syri - syni*, por jo i domosdoshëm në fjalëformim: *brezni, dashnor, grunajë, grunore, synoj*); ruajtja e bashkëtingëllores *-nj* në trup të fjalës (*banjë, i shenjtë* etj.) dhe te formanti i shumësit (*arinj, ftonj* etj.) – në gegërishte e jotacizuar: *bajë, i shejtë, arij, ftoj*), por jotacizimi i saj në paradigmën foljore (*bëj, bëja, shkoj, shkoja, nxirrja* etj. dhe jo *bënj, bënja, shkonja, nxirrnja* si në disa të folme toske sidomos lindore); shqiptimi dhe shkrimi i

<sup>17</sup> Emërtimi i plotë është “Shoqëri e të Shtypuri Shkronja Shqip” – u themelua në Stamboll më 1879 dhe veproi deri më 1891.

bashkëtingëlloreve të zëshme fundore si të tilla *elb, larg, i madh* (përballë shqiptimit dhe shkrimit si të shurdhëta në toskërishte: *elp, lark, i math*); shqiptimi dhe shkrimi me *sh* e *zh* nistore i fjalëve si *shkul, shthur, zhduk, zhvendos* etj. sipas gegërishtes përballë *çkul, çthur, çduk, çvendos* në toskërishte, dhe, nga ana tjetër, shqiptimi e shkrimi me *ç* nistore përpara sonanteve *çliroj, çnderoj, çmallem* etj., sipas toskërishtes përballë formave me *sh* të gegërishtes (*shliroj, shnderoj, shmallem*); ruajtja e bashkëtingëllores *h* në fjalë si *ftoh, i ftohtë, mpreh, i mprehtë, shoh* etj. sipas toskërishtes përballë ndërrimit të saj në *f* në gegërishte (*ftof, i ftoftë, mpre, i mpreftë, shof*); mënjanimi i shqiptimit dhe shkrimit me *ll* e *th* të një numri fjalësh të huaja me burim nga gjuhët klasike si në toskërishte (*biologji, llogjikë, arithmetikë, theatër* etj.), duke vendosur format me *l* e *t* si në gegërishten e folur (*biologji, logjikë, arithmetikë, theatër*).

### Format

Dallime relevante të shqipes standarde nga gegërishtja e folur dhe letrare për sa u takon formave, janë: mungesa e paskajores së tipit *me shkue* (*me* + pjesoren e gegërishtes) dhe e së ardhmes së ndërtuar me të (*kam me shkue*); format e pjesores më *-uar, -ur* sipas toskërishtes<sup>18</sup>; temat emërore e foljore me grupin *ua* (*ftua, shkuam, shkuat, shkuan, shkuar* etj. përballë *ue* të gegërishtes: *ftue, shkuem, shkuet ...*); pjesëza *duke* e përcjellores në vend të *tue/tuj* të gegërishtes; format e së pakryerës (*shkoja, shkoje, shkonim, shkonit* përballë *shkojsha, shkojshe, shkojshim, shkojshi, shkojshin* të gegërishtes). Si në paradigmat foljore, ashtu edhe në paradigmat emërore ka një numër rastesh në të cilat gjuha standarde del me rotacizmin e toskërishtes (*hiri, syri, vura* etj.) përballë formave me *-n-* të gegërishtes (*hini, syni, vuna*). Ndërkaq në shqipen standarde janë integruar disa forma foljore të mbipërbëra të gegërishtes si: *ka* (*kishte*) *pasë ardhur, duke pasë ditur* etj., tek të cilat është pranuar pjesorja *pasë* e gegërishtes (përndryshe do të duhej: *ka pasur ardhur, duke pasur ditur* – forma që nuk përdoren).

Në qoftë se marrim gramatikën e Sami Frashërit si pasqyruese të koinesë toske të Rilindjes dhe e krahasojmë me shqipen standarde, do të vërejmë: mënjanimin e formave të vjetra të kallëzores si *djalën, plaknë, njerinë* etj., nga format e reja *djalin, plakun, njeriun*, të përgjithësuara më herët në gegërishte; mënjanimin e mbaresave foljore *-nj, -nja* të zëvendësuara përfundimisht me *-j, -ja* (*shkoj, shkoja* e jo më *shkonj, shkonja*, të cilat S. Frashëri i ka dhënë si forma kryesore); mënjanimin e formave me dyanorin *ua* në paradigmen e aoristit të foljet me temë më bashkëtingëllore (*dolëm, morëm* etj. në vend të *dualmë, nxuarmë*); ndërrimin e vendit të zanores *-ë* fundore të mbaresat e shumësit të aoristit të foljeve konsonantike *-më, -të, -në* > *-ëm, -ët, -ën* (*hapmë,*

<sup>18</sup> Vetëm për pak folje pjesorja *ka* të njëjtën prapashtesë në të dy dialektet: *lënë, thënë, zënë* etj.

*haptë, hapnë* → *hapëm, hapët, hapën* etj.); mënjanimin e formave që S. Frashëri i ka vënë si variante nëndialektore (të toskërishtes), si *të keç (të kesh), kisham, isham, jesham (kisha, isha)* etj.

Por siç e dëshmon tani së fundi edhe “Atlasi dialektologjik”, të dy dialektet kanë shumë forma foljore të përbashkëta. Një numër formash nëndialektore jo vetëm të gegërishtes, por edhe të toskërishtes ose nuk janë përfaqësuar fare në gjuhën e shkruar, ose janë mënjeluar herët, ndër to edhe e ashtuquajtura rasë vendore (*në malt, mbi dhet* etj.), që ka qenë përdorur që nga Buzuku e deri tek autorët e shek. XX.

### **Fjalëformimi**

Në fushën e fjalëformimit tipat e modelet fjalëformuese të përbashkëta të mbarë gjuhës janë ndërthurur me tipa e modele dialektore, duke formuar një sistem fjalëformues unik, që ka pasur ndikime edhe në sisteme të tjera të gjuhës, siç është rasti i përfshirjes së togut zanor *ue* dhe i fjalëve pa rotacizëm në shqipen standarde. Kështu në “Fjalor i gjuhës së sotme shqipe” (1980, 41.000 fjalë) ka 795 fjalë (emra e mbiemra) me *-ues* dhe 260 mbiemra me *-ueshëm* (gjithsej 1055 fjalë), d.m.th. diçka më shumë se 1/40-ta e krejt fjalësit. Duhet pasur parasysh edhe se këta tipa fjalëformimi janë bërë shumë produktivë sidomos në leksikon terminologjik special, që nuk përfshihet në fjalorët e përgjithshëm shpjegues. Një prapashtesë nëndialektore e gegërishtes - *najë (akullnajë, mjegullnajë* etj.) është bërë mjaft produktive si në terminologji, ashtu edhe në publicistikë e në letërsinë artistike<sup>19</sup>.

### **Sintaksa dhe leksiku**

Në fushën e sintaksës dhe të leksikut bashkëveprimi i traditave letrare ka qenë më i fuqishëm. Sot vetëm studiues me përvojë mund të dallojnë prejardhjen e ndërtimeve sintaksore ose të fjalëve nëse janë nga tradita letrare e Veriut apo e Jugut. Vetëkuptohet se duke mbetur jashtë sistemit gramatikor paskajorja e gegërishtes *me + pjesore (me punue)*, ka mbetur jashtë edhe sintaksa e saj. Por nuk ka ndërtime të tjera në gjuhën e shkruar që të cilësoheshin si dialektore dhe jonormative. Në Kosovë dhe në përgjithësi të shqiptarët në ish Jugosllavi vërehen ndikime të sintaksës së gjuhëve sllave të Federatës (p.sh. *përgjigjem në pyetjen* në vend të *i përgjigjem pyetjes*), për të cilat tërheqin vëmendjen gjuhëtarët; kohët e fundit po bëhet i ndjeshëm ndikimi

<sup>19</sup> Në FGjSSH 1980 gjenden 31 fjalë me këtë prapashtesë: *akullnajë, arnajë, blinajë, bornajë, brinajë, drithnajë, ferrnajë, floknajë, frashnajë, fushnajë, gardhnajë, groshnajë, grunajë, gurnajë, gjethnajë, kërpnajë, krenajë, ledhnajë, lisnajë, lugnajë, lulnajë, lumnajë, mjegullnajë, oriznajë, pishnajë, pyllnajë, shkurrnajë, shulnajë, tymnajë, ujnajë, vathnajë* (vetëm fjalët e nënvizuara janë edhe në FGjSh 1954); ndërsa në FGjSh 2006 janë shtuar edhe 12 të tjera: *elbnajë, ethnajë, gjithnajë, kodërlisnajë, plepnajë, rrafshnajë, rrethnajë, rrugënajë, sheshnajë, shkoznejë, thashethemnajë, vjedhnajë*.

i anglishtes, sidomos në përdorimin e panevojshëm të përemrave vetorë kur nuk bie mbi ta theksi logjik i fjalisë, ose duke përdorur pa nevojë përemrin pronor, nën ndikimin e origjinalit anglisht, si p.sh.: *Më 1936 Meri u vendos në Londër, por ajo* (e panevojshme) *nuk u mësua dot me jetën e atij qyteti ... Erdhi bashkë me gruan dhe me vajzën e tij* (e panevojshme); po kështu edhe përdorimi i fjalës *një* kudo që në gjuhët e origjinalit ka një nyjë joshquese (*a, un, uno, ein* etj.), p.sh.: *ka një rëndësi të madhe, i kushton një vëmendje të veçantë, ka marrë një përhapje të gjerë* etj. në vend të *ka rëndësi të madhe, i kushton vëmendje të veçantë, ka marrë përhapje të gjerë* etj.

Në fushën e leksikut, për të përdorur një shprehje të akad. Idriz Ajetit, gjuha letrare i ka pasur me kohë dyert të hapura në të dy krahët. Mjafton të përmendim se në terminologjinë gramatikore terma si *asnjanës, gjignore, dhanore, rasë, zanore* janë prej gegërishtes dhe kanë mënjeluar termat toskërisht të formuar prej gramatikanëve toskë (*astjetër, pjellëtore, dhënëtoore, rënie, zërore*). Në kërkim të mjeteve shprehëse dhe për të mënjeluar huazimet krahinore prej gjuhëve fqinje shkrimtarët nga Jugu u drejtohen shpesh fjalëve të Veriut dhe anasjelltas. Shembulli më domethënës është Ismail Kadareja, që jo vetëm ka qëmtuar dhe ka hedhur në veprat e tij mjaft fjalë të gegërishtes, të përfaqësuara pak ose aspak në letërsi, por edhe ka krijuar fjalë të reja sipas gegërishtes. Në fushat e fjalëformimit, të leksikut, po edhe të sintaksës mund të thuhet se koineja letrare shqipe përfaqëson një madhësi unitare, pa raporte dialektore të dallueshme.

Duke përmbyllur këtë parashtrim do të shtoj se shqipja standarde ka bërë përparime të dukshme në këtë gjysmë shekulli nga Kongresi i Drejtshkrimit (1972), i cili pati jehonë të gjerë në shoqërinë shqiptare dhe solli forcimin e kërkesave për zbatimin e rregullave të gjuhës në një vend si Shqipëria, ku shkujdesja dhe liberalizmi ka mbizotëruar mbi disiplinën gjuhësore. Vështirësitë janë të shumta dhe gjendja, siç thuhet frëngjisht me një ngjyrim eufemizmi, lë për të dëshiruar (*laisse à désirer*). Me sa jam në dijeni, kultura dhe sjellja gjuhësore në Europën e sotme, nuk kanë më atë rol dhe prestigj shoqëror si dikur. Kjo ndihet aq më tepër në një vend si Shqipëria, ku gjuha e vendit ka vetëm një shekull jetë si gjuhë zyrtare, ku universiteti u themelua para 65 vjetësh, ndërsa forma e njësuar e gjuhës u arrit në fillim të viteve '70. Por është me rëndësi të theksohet se në opinionin shoqëror po vjen duke u forcuar interesimi për një kulturë gjuhësore më të lartë dhe parregullsitë në përdorimin publik të gjuhës shkaktojnë pakënaqësi e reagime.

Së fundi fare dua të përmend edhe një rrethanë që besoj ka rëndësi të mbahet parasysh. Më 1967, kur u botua projekti i drejtshkrimit dhe u gjallërua diskutimi për gjuhën letrare, në Shqipëri u ndalua veprimtaria e institucioneve fetare. Më 1990, kur rifilluan veprimtarinë e tyre institucionet e të tria besimeve (myslimane, ortodokse e katolike), gjetën një gjuhë standarde me rregulla të përcaktuara. Ato jo vetëm nuk e kundërshtuan, por kërkuan

bashkëpunimin e gjuhëtarëve me përvojë për të redaktuar përkthimet e librave të tyre të shenjta dhe të shërbesave të tjera të kultit, në mënyrë që të kishin një paraqitje gjuhësore sa më korrekte. Duhet vlerësuar në mënyrë të veçantë qëndrimi i kishës katolike, që duke e pasur grigjën e vet kryesisht nga Veriu, me një realizëm të admirueshëm nuk është pajtuar me thirrjet për rikthim në traditën e vjetër të shërbesave në gegërishten e dikurshme. Madje edhe në një qytet si Shkodra, ku veprimtaria kishtarë katolike në idiomën vendore ka pasur traditë të gjatë, tani vërejmë se gjuha standarde po merr epërsi jo vetëm në botime, por edhe në predikim. Për filologët shqiptarë gjuha e botimeve dhe e veprimtarisë fetare është bërë një fushë tërheqëse hulumtimesh. Janë kryer botime kritike e studime të gjuhës së veprave të letërsisë fetare të shekujve XVI, XVII e në vijim, janë zhvilluar edhe simpoziume të posaçme për terminologjinë fetare dhe për probleme të tjera të përdorimit sa më korrekt të gjuhës shqipe në këtë fushë. Natyrisht kjo është një përkrahje e çmuar për zgjerimin e funksioneve dhe të sferës së veprimit të shqipes standarde.

## SUMMARY

### LITERARY ALBANIAN AS A SUPRADIALECTAL KOINÉ

Standard Albanian (SAL) has been defined as a literary koinè sui generis (A. Kostallari). Certainly, every literary form defined as koinè has specific characteristics resulting from the material, the period and the circumstances of its origin, and therefore the epithet sui generis is automatically implied. The formation of the SAL has been a process in which historical, confessional, cultural, i.e. extra-linguistic, as well as linguistic circumstances have had a decisive influence. First, the relatively young literary tradition of the Albanian language (the first two books date back to the 16th century) was almost lost in the difficult circumstances of the Ottoman period and mass Islamisation (18th century); with the Albanian National Awakening (Rilindja Kombëtare Shqiptare) in the 19th century, it was necessary to start from scratch in some areas. Secondly, the Albanians, one of the oldest peoples in the Balkans, only managed to have their own state, functioning in the Albanian language, at the end of 1912. For this reason, and because the Ottoman Empire did not allow education and publications in the Albanian language in the four Albanian-populated vilayets of Rumelia, the centres of Albanian language cultivation and publications were located outside the territory of these vilayets, mainly in the colonies of Albanian emigrants (Istanbul, Romania, Bulgaria, Egypt, USA, etc.). Thirdly, given that the Albanians have three main religious confessions (Muslim, Orthodox, Catholic), religious activity and publications in this sphere could not play the role that they had in other peoples for the formation and

diffusion of their literary languages; here we must also bear in mind the fact that written Albanian entered into the publications and practice of the Islamic religion with a great delay (about 65-70% of the Albanian population). Fourthly, the cultural situation in the Albanian areas was characterised by mass illiteracy (even 15 years after the proclamation of independence, in 1927, when Albania had a population of 830,000, only 63,000 had some form of education); moreover, there were very marked disparities between the various regions in terms of cultural and educational development (78% of the educated people came from the regions of southern Albania), and consequently the various Albanian regions were very unequally represented in literary life and in publications. In the northeastern and eastern regions, which were incorporated into the Yugoslav kingdom after 1918, Albanians had no schools in their mother tongue and were therefore unable to participate in the literary movement. Fifthly, during the Ottoman period (16th-19th centuries), the internal development of the Albanian language followed different trends: the northern varieties (Gheg) underwent a series of innovations, while the southern varieties (Tosk) were more conservative and generally preserved the linguistic state of the pre-Ottoman period. This state of the two main dialects was also reflected in the language of the Albanian Awakening (Rilindja), which was mainly based on the spoken Albanian of the time. As a result, two main varieties of literary Albanian developed: the literary variety of the north (literary Gheg) with two sub-varieties: the first (the most complex) was based on the northwestern dialects (also known as literary Scutarine), and the second was based on the dialects of the southern Gheg (also known as literary Elbasan and represented mainly by the translations of K. Kristoforidhi): The New Testament and parts of the Old Testament). Alongside these varieties, the so-called Tosk literary koinè (or literary Tosk) developed. The birth of this Tosk koinè is motivated by three circumstances: On the one hand, the dialectal landscape of the Tosk variety (southern Albania) is much softer than the dialectal landscape of the Gheg variety, and on this basis the popular poetry of the south had reached a kind of koinè that provided material for the writers and poets of the 19th century, who relied heavily on folklore; On the other hand, the varieties of labërishte and çamërishte (subdialects of Tosk with some specific peculiarities) were almost no longer used in written Albanian from the second half of the 19th century (the writers of these regions used the Tosk koinè). Under these circumstances, from the 1880s onwards, various ideas emerged on how to create a national literary language for all Albanians. In addition to the promotion of one of the above-mentioned varieties to the status of a common literary language, there were attempts to experiment with a mixture of Gheg-Tosk dialect forms in the written language, in order to create a variety that could be understood by everyone.

Another unsuccessful compromise idea was the creation of a new literary standard based on the varieties of Central Albanian, which included phonetic and morphological elements of Gheg and Tosk.

In the inter-war Albanian state, all three of these varieties continued to be used, although a linguistic commission meeting in Scutari between 1916 and 1918 had directed the development of the literary language towards the southern Gheg variety (the Elbasan literary variety). This variety was adopted by the Albanian government in 1923 as the compulsory bureaucratic variety for administration (but not for school texts, literary production, publications, translations, etc.). The creation of the common national literary Albanian (SAL) will come after the Second World War, i.e. in the period of the socialist system. A number of factors contributed to this, mainly cultural and educational. The current standard Albanian is an organic development of the Tosk koinè, which, especially in the years 1950-1970, absorbed important hetero-dialectal elements, transforming itself from a koinè within the Tosk into a koinè with elements also of Gheg origin. Through a process of selection in linguistic practice, the current form of literary Albanian and its norm were already crystallised in principle, and sanctioned at the Orthography Congress (1972). Albanians from the former Yugoslavia were also represented at this congress, having voluntarily accepted the "literary language of the motherland" since 1968, in accordance with the principle they themselves proclaimed: "One nation - one national literary language". In this solution, the political factor influenced as a factor of cultural order, that is, the development of the linguistic system based on the educational-cultural situation of the population and the rich tradition of cultivating the Tosk variety during and after the National Awakening, was supported. The case of SAL belongs to the type of solution based on the combination of the internal linguistic factor (the greater uniformity of the dialect base) with the cultural factor (the greater number of participants and the more profitable tradition of cultivation on the dialect base, supported by the state factor).